


MASKA

*Revista Elektronike
Radio e RII në gjuhën shqipe
Nr.6 Prill i vitit 2017.*



Pozita e mercenarëve në të drejtat ndërkombëtare dhe roli i Muxhahedine Khalk në luftën e Irakut kundër Iranit

Dr. Alireza Asadpur Teherani,

"Mercenarizmi nuk është një koncept i ri ose një fenomen i ri në të drejtën dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare".

Ky koncept dhe fusha e tij në të drejtën ndërkombëtar, ka pësuar disa ndryshime. Në një periudhë, pozita dhe gjendja e mercenarëve, kishte rëndësi më të vogël dhe në një periudhë tjetër, mercenarët ishin pjesë e prioritetëve të Bashkësisë Ndërkombëtare. Që nga koha kur filloi

agresioni ushtarak i Irakut kundër Iranit dhe bashkëpunimi politik, ushtarak dhe inteligjent i organizatës së quajtur Muxhahedine Khalk me regjimin e Sadam Husejnit dhe me ushtrinë e tij, kjo çështje ka marrë

dimensione të veçanta. Prandaj në këtë artikull synojmë të shqyrtojmë këtë çështjeje se a mund të ndiqet penalisht nëpër gjykata ndërhyrja e organizatës Muxhahedine Khalk si një forcë mercenare me qëllime edhe pse të ndryshme nga të dy palët e përfshira në luftë, mirëpo që ishte në favor të njëres palë të përfshirë në konflikt, do të thotë Irakut?

Kuptimi gjuhësor

Nga aspekti etimologjik, fjala mercenary në gjuhën angleze dhe mercenaire në gjuhën franceze, rrjedh nga fjala mercenarius në gjuhën latine dhe ka kuptimin e një individi i cili ofron

shërbime vetëm në shkëmbim të parave. Ky term përdoret sidomos në lidhje me një ushtar i cili ofron shërbimet e tij ushtarake për të huajt në shkëmbim të marrjes së pagës dhe pa marrë parasysh parimet politike. Ky term në gjuhën angleze ka hyr në përdorim nga shekulli 14. Mirëpo shfrytëzimi i shërbimeve ushtarake të individëve, është një profesion i cili daton që nga periudha e Greqisë së Vjetrës.

Rruga e formimit të mercenarizmit

Shfrytëzimi i mercenarëve sidomos në operacionet ushtarake daton që nga periudha e shteteve-qytete të Greqisë së Vjetër. Për shembull në dy shtete-qytete rivale Athinë dhe Sparta, banorët që jetonin në qytet ndaheshin në dy kategori, qytetarë dhe jo qytetarë. Me emrin qytetarë quheshin ata persona të cilët ishin meshkuj të moshës 15 deri 70 vjeç dhe që nuk kishin ndonjë

gjymtyrë fizike të mangët në trup. Prandaj, femrat (të çfarëdo moshe), fëmijët, adoleshentët dhe pleqtë, nuk konsideroheshin qytetarë. Grupi tjetër që nuk quhej qytetar përbëhej nga burrat të cilët u kishin borxh burrave të tjerë dhe nuk kishin mundësi të paguanin borxhin atyre. Këta burra borxhlinj duhej të punonin për burrat që kërkonin borxhin për një kohë të caktuar (e cila kryesisht imponohej nga burrat që kërkonin borxhin). Një prej punëve që borxhlinjtë ishin të detyruar ta kryenin për të paguar borxhin, ishte pjesëmarrja në luftë.

Gradualisht disa persona të pasur të Athinës në kohën kur bashkoheshin me spartanët për të



luftuar kundër Perandorisë Persiane, në shkëmbim të një shume të parave dhe me premtim të plaçkës së luftës, në vend të tyre dërgonin disa persona të tjerë në betejën e luftës me qëllim që nga njëra anë, të kryejnë njërën prej obligimeve të "qytetarit", por edhe për arsye që në mungesë të tyre, personat e tjerë të mos grabisin dhe plaçkitin pasurinë dhe familjen e tyre. Përveç kësaj, grekët i konsideronin barbarë të gjithë popujt e tjerë jo grekë, prandaj mendonin se grekët e meritojnë një superioritet ndaj tyre dhe janë "zotërinj" të popujve të tjerë dhe si rezultat popujt e tjerë duhet të jenë skllëvër të tyre. Kjo çështje është theksua edhe në librin "Politika" të Platonit. Ai besonte se ekzistojnë njerëz të cilët ku do që të jetojnë, gjithmonë janë skllëvër dhe në të kundërtën ekzistojnë njerëz të cilët kurrë dhe në asnjë vend nuk janë skllëvër. Ky grup i fundit janë pikërisht ata qytetarë grekë. Qytetarët grekë, jo vetëm në vendin e tyre, por edhe në të gjithë botën, konsiderojnë se kanë të drejtën për të qenë qytetarë, ndërkohë që barbarët vetëm në vendin e tyre janë me origjinë të mirëfilltë, ndërsa me të dalë nga vendi i tyre (nëpërmjet udhëtimeve ose nëpërmjet luftës dhe të ngjashme), konsiderohen skllëvër. Grekët gjatë luftës me persianët, me disa persona të cilët i zinin robër, nënshkruanin kontratë në bazë të të cilës nëse ata do të marrin pjesë në disa luftëra si përfaqësues të tyre, mund të ktheheshin në vendin e vet ose pas një periudhe në shkëmbim të pjesëmarrjes në luftëra si përfaqësues të të tjerëve, mund të marrin një shumë të parave ose një pjesë të plaçkave të luftës.

Perandoria Romake gjithashtu në mënyrë graduale, ka bërë përpjekje që forcat e armatosura të saj t'i përbëjë nga individë të cilët konsideroheshin luftëtarë profesionalë. Këta individë quheshin "legjionarë". Sukseset dhe zgjerimi kryesor i Perandorisë Romake ishte arritur për shkak të formimit të një ushtrie të tillë. Kjo ishte për arsye se pushtimi i sa më shumë territoreve për çdo ushtarë legjionarë, ishte i barabartë me marrjen e më shumë plaçkave dhe pasurive të luftës.

Kjo ide, në periudhën e Mesjetës dhe më pas në Evropës është ndjekur në kuadër të "Gardave

Zvicerane", "Legjioni i Huaj i Francës" Brigada Gurkay e ushtrisë së Britanisë së Madhe etj..

Dekada e gjashtë të shekullit 20, ishte një periudhë në të cilën fitoi rëndësi përsëri fenomeni i mercenarizmit ose mercenarit për arsye të krijimit të lëvizjeve kundër kolonializmit (sidomos në kontinentin e Afrikës). Shumica e shteteve kolonialiste për të luftuar kundër lëvizjeve që kërkonin pavarësi, kanë mbledhur njerëz të kombësive të ndryshme dhe i paguanin me para ata që të luftojnë kundër forcave që kërkonin pavarësi.

Ndryshimet konceptuale në sferën e të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme

Në të drejtën ndërkombëtare të normës klasike, mercenar është një ushtar i cili ka bërë betimin që të jetë i nënshtruar ndaj një shteti ose një mbreti dhe shërbimin ushtarak e vendos në dispozicion të atij shteti ose mbreti. Parimisht, në bazë të kësaj teorie, qëllimi i mercenarit në ofrimin e shërbimeve ushtarake, përveç përfitimeve materiale, ishte edhe përftimi moral (fitimi i famës, kredibilitetit, nderit, ngritjes së prestigjit familjar dhe të ngjashme).

Nga ana tjetër, duket se nga aspekti i historisë së zhvillimit të të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, në konceptimin normativ dhe klasik, për mercenarin, përftimi material dhe përftimi moral kishte rëndësi të barabartë.

Forca më e njohur dhe ndoshta më e vjetër që mund të prezantohet si model i mercenarizmit, është Garda Zvicerane e vendosur në Vatikan. Kjo forcë, që nga shekulli i 15 e deri më tani ka vepruar si forca mbrojtëse e Papës dhe e vendeve nën administrimin e tij. Në shekullin e 15, Garda Zvicerane ofronte shërbime ushtarake jo vetëm për Papën, por shërbimet ushtarake të saj shfrytëzoheshin edhe në oborret mbretërore të vendeve të tjera evropiane. Deri në shekullin 18, Garda zvicerane ka vazhduar të ofrojë shërbimet e saj ushtarake. Në vitin 1874, me miratimin e Kushtetutës së Konfederatës së Zvicrës, u ndalua imuniteti ushtarak dhe ofrimi i shërbimeve ushtarake të zviceranëve për fuqitë e huaja u ndalua me ligj. Mirëpo deri në vitin 1927,

praktikisht zviceranët kanë vazhduar ofrimin e shërbimeve ushtarake të tyre për shtetet evropiane, natyrisht në emër të shërbimeve ushtarake vullnetare. Me kalimin e kohës dhe me shfaqjen e konceptit "shërbime ushtarake vullnetare", gradualisht u prish balancimi mes qëllimeve materiale dhe morale për kryerjen e shërbimeve ushtarake dhe në praktikë qëllimet materiale morën rëndësi më të madhe në krahasim me qëllimet morale. (Natyrisht se në mënyrë sipërfaqësore kjo bëhej në emër të qëllimeve morale dhe vullnetare). Në realitet me rënien e primeve morale që sundonin në shoqëritë evropiane, parimet morale që sundonin në luftë gjithashtu pësuan rënie të madhe. Kjo rënie ishte deri në atë masë sa që shumica e mbretërve për të arritur në fitoret më të shpejta, shtuan numrin e forcave mercenare me emra të ndryshëm nganjëherë edhe duke i dhënë epitete atyre si "Chavalier". Duke marrë parasysh faktin se qëllimi i mercenarëve ishte arritja e përfitimeve sa më të mëdha në një kohë sa më të shkurtë, ata në praktikë skenën e luftës e konsideronin si një vend tregtie dhe private duke mos bërë kurrfarë dallimi mes personave ushtarak dhe civilë. Në këtë mënyrë humbi tërësisht koncepti i luftës së barabartë.

pranimin e individëve në strukturat e kësaj force, ishte ky që pranimi individëve bëhej duke mos marrë parasysh të kaluarën e tyre. Legjioni ishte një forcë e përbërë nga vullnetarët kryesisht jo francezë dhe qëllimi i formimit të saj, ishte administrimi dhe shtypja e kryengritjeve në kolonitë franceze. Pas një kohe, për vendosjen e forcës Legjioni i Huaj i Francës u zgjodh kolonia franceze Algeria. Gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918), këto forca si një degë e ushtrisë franceze, në mënyrë zyrtare hyrën në betejën e luftës.

Sipas rregullave të veçanta të kësaj dege të ushtrisë së Francës, pjesëtarët e huaj pas kalimit të rreth pesë viteve ose menjëherë pas mbetjes me të meta fizike, merrnin shtetësinë franceze. Në këto forca nuk kishte kufizime për pjesëmarrjen edhe të shtetasve francezë. Edhe francezët mund të bëheshin pjesëtarë të kësaj force. Këta individë në të shumtën e rasteve ishin të burgosur që nëse dëshironin të anëtarësoheshin në këtë Legjion, sipas ligjit i ulej dënimi dhe në fund të periudhës së shërbimit, ata liroheshin nga burgu. Të gjitha forcat pa marrë parasysh shtetësinë dhe motivin e anëtarësimit dhe duke marrë parasysh gradën ushtarake,



Në vitin 1831 Lui Filip, mbreti i Francës, formoi një forcë speciale me emrin Legjioni i Huaj i Francës "French Foreign Legion", e cila në realitet ishte formuar në bazë të modelit të Gardës Zvicerane. Që nga themelimi i forcës Legjioni i Huaj i Francës, parimi më i rëndësishëm për

merrnin paga. Duke marrë parasysh këto rregulla, disa ekspertë të fushës juridike besojnë se pjesëtarët e Legjionit të Francës nuk konsiderohen mercenarë.

Prandaj, mund të thuhet se nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare klasike, mercenarë janë

ushtarakët profesionalë të cilët pa marrë parasysh shtetësinë dhe vendqëndrimin e tyre dhe të palëve të përfshira në luftë, ofrojnë shërbime ushtarake për çdo palë që i paguan ata. Qëllimi kryesor i mercenarëve nuk është besnikëria ndaj idealeve të caktuara politike ose shoqërore, por vetëm përfitimet material. Për këtë arsye, ata nuk e konsiderojnë vetën të obliguar që të respektojnë ligjet e brendshme ose ligjet ndërkombëtare.

Pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare bashkëkohore

Pasi fituan rëndësi dhe prioritet në mënyrë graduale të drejtat ndërkombëtare konvencionale ndaj të drejtave ndërkombëtare normative dhe pas zhvillimeve të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, Organizata e Kombeve të Bashkuara që nga themelimi i saj, me anë të disa dokumenteve e dënoi fenomenin e mercenarizmit dhe e quajti atë shkelës të zotimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, sidomos të paragrafit 1 (ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare), të paragrafit 2 (zhvillimi i marrëdhënieve miqësore) të nenit 1 dhe të paragrafit 4 të nenit 2 (mospërdorimi i forcës ose moskërcënimi me forcë). Përveç kësaj, edhe Asambleja e Përgjithshme edhe Këshilli i Sigurimit me anë të disa rezolutave, deklaruan se shfrytëzimi i mercenarëve është një lloj ndërhyrje e huaj në çështjet e brendshme të vendeve me qëllim të destabilizimit dhe shkeljes së integritetit territorial, sundimit dhe sovranitetit kombëtar të tyre. Kjo çështje ka rëndësi për OKB deri në atë masë sa që kjo organizatë ka themeluar zyre raportuese speciale për këtë çështje. (Për shembull referohuni në rezolutat 405 dhe 419 të Këshillit të Sigurimit të OKB të miratuara në vitin 1977 dhe në rezolutën 36/103 të miratuar më 9 dhjetor 1981 në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara).

Në vitin 1979, Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi konventën ndërkombëtare kundër punësimit, përdorimit, sigurimit të burimeve financiare dhe trajnimit ushtarak të mercenarëve. Kjo konventë hyri në fuqi për zbatim më datë 20 tetor 2001. Pati nevojë për një periudhë gati 12 vjet derisa të hyjë në fuqi për zbatim një

konventë ndërkombëtare dhe kjo mund të tregojë që shumë vende akoma nuk kanë kuptuar rëndësinë e ndalimit të punësimit të mercenarëve në konfliktet armiqësore ose kjo është bërë për arsye të interesave materiale dhe morale që siguron punësimi i mercenarëve. Kjo është për arsye se fuqizimi për zbatim i një konvente të tillë, bëhet shkak që të ndërpriten interesat shumë të mëdha të tyre.

Organizata e Unionit të Afrikës në vitin 1977 miratoi konventën për zhdukjen e punësimit të mercenarëve në Afrikë dhe në këtë konventë mercenarizmi dhe punësimi i mercenarëve për konflikte, konsiderohet krim kundër paqes dhe sigurisë në Afrikë, edhe në rast se ky veprim bëhet nga ana e një individi, një grupi, një organizate, një shteti ose një përfaqësuesi të një qeverie.

Në vitin 1967, Këshilli i Sigurimit i OKB kërkoi nga qeveritë që t'i shmangen punësimit të mercenarëve në vendin e tyre me qëllim të ndryshimit të regjimit politikë. Në qershor të vitit 1977, protokollin shtesë në konventat e Gjenevës së vitit 1949 në nenin 47 ka trajtuar gjendjen e mercenarit dhe ka përcaktuar si në vijim:

(1) Mercenari nuk ka të drejtë të konsiderohet luftëtar ose rob luftime.

(2) Mercenar është ai i cili:

a- Është punësuar me pagesë në vend ose jashtë vendit për të luftuar në konfliktin e armatosur;

b- Praktishtë të ketë marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në konfliktet luftarake;

c- Motivi kryesor i tij nga pjesëmarrja në konflikte luftarake, esencialisht të jenë interesat personale dhe në realitet njëra nga palët e përfshira në konflikt t'i ketë paguar atij shpërblime materiale në sasi shumë më të madhe se sa shuma që u paguhet luftëtarëve të të njëjtës gradë ushtarake dhe që kanë detyrë të ngjashme në forcat e armatosura të asaj pale dhe ose t'i kenë premtuar shpërblim të tillë atij;

d- Të mos jetë shtetas ose banor i vendit që është nën kontroll të palës armiqësore;

e- Të mos jetë pjesëtar i forcave të armatosura të njëres palë luftarake;

f- Të mos jetë dërguar nga ana e shtetit i cili nuk është palë armiqësore si pjesëtar i forcave të armatosura të atij shteti me qëllim të kryerjes së detyrës zyrtare".

Tre konkludime kryesore që mund të nxirren nga ky nen janë si në vijim:

I pari- mercenar është personi i cili nuk ka interes të

drejtpërdrejtë në mbrojtjen e një vendi për të hyrë në një luftë.

I dyti- qëllimi kryesor i mercenarit nga ndërhyrja në konflikt është

përftimi material ose të paktën interesat materiale plotësisht ngadhënjëjnë ndaj interesave morale.

I treti- mercenari nuk konsiderohet luftëtar i ligjshëm. Për arsye se ai nuk është pjesëtarë i forcave të armatosura të të dy palëve të përfshira në konflikt.

A mund të konsiderohet mercenar Organizata Muxhahedine Khalk?

Siç duket organizata e quajtur "Muxhahedine Khalk" dhe strukturat e varura prej saj si "Ushtria Çlirimtare Kombëtare", "Pishmargat e Muxhahedine Khalk" dhe të ngjashme me këto, plotësojnë të gjitha kushtet e mercenarizmit:

Për arsye se kjo organizatë: 1- në mënyrë të veçantë është paguar nga ushtria e Irakut për të luftuar në kufijtë e Iranit (paragrafi (a) i

protokollit shtesë). Në mënyrë të drejtpërdrejtë ka marrë pjesë në luftën Iran-Irak (paragrafi (b) i këtij protokollit).

2- Motivi kryesor i kësaj organizate nga pjesëmarrja në luftë, ishte interesi personal (marrja e pushtetit në Iran me forcë dhe dhunë) dhe ushtria e Irakut, kësaj organizate i ka dhënë shpërblime të mëdha materiale (paragrafi c).

3- Pjesëtarët e kësaj organizate në Irak nuk ishin as shtetas irakianë dhe as nuk kishin qëndrim të ligjshëm në Irak (kjo është një çështje që kërret e Muxhahedine Khalk e kanë pohuar vazhdimisht në kampin Ashraf dhe e pohojnë aktualisht) (paragrafi d).

4- Muxhahedin e Khalk gjithmonë ka bërë përpjekje që në të gjitha operacionet e mëdha dhe të vogla dhe sidomos gjatë

trajnimeve, të përdorë uniformë të dalluar nga aspekti i ngjyrës (por pa emblema dhe simbole të caktuara dhe të pandryshuara ushtarake) nga uniformat e të dy palëve të përfshira në konflikt. Përveç kësaj, ushtria e Irakut as në mënyrë direkt dhe as në mënyrë indirekte, kurrë nuk ka pranuar



anëtarësimin e kësaj organizate në forcat e veta të armatosura (paragrafi e).

5- Asnjë prej forcave të armatosura të vendeve të paanshme të lidhura me konfliktin Iran-Irak, gjithashtu kurrë nuk kanë pretenduar se grupin Muxhahedine Khalk e kanë dërguar në rajonin e konfliktit për të kryer ndonjë detyrë zyrtare ose jo zyrtare (paragrafi f).

Disa ekspertë të së drejtës juridike besojnë se përkufizimi i mercenarit në bazë të nenit 47, është një koncept juridik i ngushtë dhe i kufizuar. Si rezultat sipas këtij protokollit, një person mund të njihet si mercenar atëherë kur t'i posedojë të gjitha 6 kushtet e përmendura në paragrafin 2 të nenit të lartpërmendur. Koncepti i kundërt i këtij konkludimi të fundit është ky që nëse çdo individ edhe nëse nuk posedon njërën prej këtyre kushteve, ai nuk mund të konsiderohet mercenar.

Pyetja e cila lind në bazë të këtij konkludimi është kjo që nëse një person në mënyrë të drejtpërdrejtë ka marrë pjesë në një luftë, por nuk konsiderohet mercenar, atëherë çfarë statusi do të ketë? Një person i tillë a duhet me patjetër dhe në mënyrë obligative të konsiderohet luftëtar?!

Për tu përgjigjur në këtë pyetje dhe të ngjashme me këto, duhet të referohemi në katër konventat

e Gjenevës dhe protokolleve shtesë të tyre dhe në të drejtën ndërkombëtare normative.

Nga një aspekt mund të thuhet se protokollit dhe konventat e Gjenevës në përgjithësi njerëzit i ndajnë në dy kategori: personat e përfshirë në luftë dhe personat që nuk janë përfshirë në luftë. Personat e përfshirë në luftë gjithashtu ndahen në tre grupe të cilat janë: luftëtarët, agjentët e spiunazhit dhe mercenarët.

Përkufizimi i luftëtarit

Neni 43 i protokollit të parë shtesë në përkufizimin e luftëtarit përcakton: 1- forcat e armatosura të një pale të përfshirë në luftë përbëhen nga forcat armatosura të organizuara, grupet dhe njësitë të cilat janë nën mbikëqyrjen e komandës përgjegjëse për veprimet e pjesëtarëve të vet përball palës tjetër, edhe nëse shteti ose një funksionar të jetë përfaqësues i asaj pale që pala tjetër e përfshirë në luftë nuk e ka njohur zyrtarisht. Një forcë e tillë e armatosur duhet të ndjekë një sistem disiplinor të brendshëm që në këtë kuadër duhet të respektojë dhe zbatojë rregullat e të drejtave ndërkombëtare që janë të zbatueshme në konfliktet e armatosura.

2- Pjesëtarët e forcave të armatosura të një palë të përfshirë në luftë (përveç punonjësve të ekipit mjekësor dhe punonjësve fetarë që janë përfshirë në nenin 33 të konventës së tretë), konsiderohen luftëtarë.

3- Kur do që njëra prej palëve të përfshira në konflikt, disa forca paramilitare ose disa forca të armatosura zbatuese të ligjit i bashkon me forcat e veta, duhet ta bëjë informimin përkatës të palës tjetër në lidhje me këtë çështjeje.

Siç duket, standardi më i rëndësishëm për ta njohur luftëtarin nga joluftëtarin, është ky që luftëtar është individ i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë merre pjesë në luftë.

Neni 44 i protokollit të lartpërmendur përcakton se nëse luftëtarin kapet nga forcat e palës tjetër, ai gëzon statusin e robit të luftës. Natyrisht se ai ka për detyrë që gjatë një sulmi ose gjatë



operacioneve ushtarake përgatitore për fillimin e luftës, ta dallojë vetën nga personat civilë.

Neni 4 i Konventës së Gjenevës në lidhje me trajtimin e robërve të luftës i datës 12 gusht 1949 (konventa e tretë e Gjenevës), deklaron:

"a- personat në vijim që i përkasin njërës prej kategorive të shpjeguara më poshtë të cilët janë kapur robër luftime, konsiderohen robër luftime në atë mënyrë që përshkruhet nga ky traktat. Këta persona janë:

1- Pjesëtarët e forcave të armatosura të njërës prej palëve të armiqësuar dhe gjithashtu pjesëtarët e grupeve guerile dhe grupeve vullnetare të cilët janë pjesë të forcave të armatosura.

2- Pjesëtarët e grupeve guerile dhe pjesëtarët e grupeve të tjera vullnetare duke shtuar edhe pjesëtarët e grupeve të rezistencës që i përkasin një shteti të përfshirë në luftë të cilët brenda ose jashtë territorit të vet janë duke kryer operacione edhe në qoftë së territori në fjalë të jetë pushtuar, me kusht që grupet guerile ose grupeve vullnetare dhe grupeve të tjera që përbëjnë rezistencën e lartpërmendur, të posedojnë të gjitha kushtet si një vijim:

a) Një person duhet të jetë kryetar në krye të tyre i cili do të jetë përgjegjës për ndjekësit e tij.


b) Të posedojnë simbol të caktuar dhe të pandryshuar i cili mund të përcaktohet edhe nga largësia.

c) Në mënyrë të hapur të bartin armë.

d) Në operacionet e veta të veprojnë sipas rregullave dhe normave të luftës.

3- Pjesëtarët e forcave të armatosura të sistemuara të cilat e prezantojnë vetën të varur nga qeveria ose nga një autoritet i cili nga qeveria që ka arrestuar ata, nuk është njohur zyrtarisht.

4- Personat të cilët janë në shoqërim të forcave të armatosura, pa qenë drejtpërdrejtë pjesë e atyre forcave si pjesëtarët e grupeve civile punonjës të avionëve luftarakë (gazetarët e luftës), sigurues të mallrave, pjesëtarë të njësive të punës ose të shërbimeve të cilët janë përgjegjës për plotësimin e nevojave të forcave të armatosura. Me kusht që ata të jenë të lejuar për veprime të tilla nga ana e forcave të armatosura të cilat i shoqërojnë. Për këtë qëllim forcat e armatosura të lartpërmendura janë të obliguara që tu japin kartë identifikuese këtyre personave.



5- Punonjësit e forcave detare tregtare si komandantët dhe kapitenët e anijeve, nxënësit dhe punonjësit e avionëve shtetërorë të vendeve të armiqësuar të cilët në bazë të ligjeve të tjera ndërkombëtare, gëzojnë trajtim më të përshtatshëm.

6- Banorët e territoreve të pa pushtuara të cilët në kohën e afrimit të armikut, pa patur rast të formojnë forca të organizuara dhe të sistemuara, në mënyrë vullnetare kapin armët për të luftuar me armikun, me kusht që ata të bartin armë në mënyrë të hapur dhe të respektojnë rregullat dhe normat e luftës.

b) Personat e më poshtëm përfitojnë nga marrëveshja e cila është caktuar në bazë të kësaj traktati për robërit e luftës:

1- Personat të cilët i përkasin ose i përkasin forcave të armatosura të vendit të okupuar, në rast se shteti okupator e konsideron nevojë arrestimin e tyre edhe nëse ata t'i ketë liruar më parë në kohën kur lufta vazhdonte jashtë territorit të pushtuar, sidomos në rast se personat e lartpërmendur nuk kanë arritur të bashkohen me forcat e armatosura të tyre në luftën brenda edhe pse kanë tentuar një gjë të tillë ose në raste kur personat e lartpërmendur nuk kanë respektuar paralajmërimet e bëra për arrestimin e tyre.

2- Personat që i përkasin një prej kategorive të shpjeguara në këtë nen që shtetet e paanshme ose të pa armiqësuar i kanë pranuar ata në territorin e tyre dhe sipas ligjeve ndërkombëtare janë të obliguara që t'i arrestojnë ata, me kusht të çfarëdo lloji marrëveshjeje më të përshtatshme që dëshirojnë të bëjnë shtetet e lartpërmendura në lidhje me personat në fjalë, me përjashtim të rregullave të neneve 8, 10, 15, paragrafit 5 të nenit 30, neneve 58 deri 67 dhe të neneve 92 dhe 126, si dhe me përjashtim të rregulloreve përkatëse me shtetet mbështetëse të cilat gjatë kohës kur të jenë vendosur marrëdhënie politike mes shteteve armiqësore me shtetet e paanshme ose joarmiqësore. Në kohën kur ekzistojnë marrëdhëniet politike të tilla, shtetet armiqësore të cilave i përkasin personat e lartpërmendur, do të jenë të lejuar që ndaj atyre personave të

zbatojnë detyra të caktuara të cilat në bazë të kësaj konvente bien mbi supe të shteteve mbështetëse, ndërkohë që ky veprim nuk redukton detyrat që zbatojnë shtetet e lartpërmendura në bazë të normës dhe traktateve politike dhe konsullore.

c) Ky nen e ruan statusin e punonjësve të shëndetësisë dhe punonjësve fetarë sipas asaj që është paraparë në nenin 33 të kësaj konvente".

Vërehet se në këtë konventë çështja dhe gjendja e robërve të luftës është trajtuar gjerë e gjatë. Disa ekspertë të çështjeve juridike besojnë se sipas "protokollit të vitit 1977, të gjitha forcat, të gjitha grupet dhe të gjitha njësitë e armatosura dhe të organizuara që veprojnë nën urdhrat e një komandanti, janë përgjegjës për veprimet e pjesëtarëve nën komandën e tyre dhe posedojnë një regjim policor dhe disiplinor të brendshëm i cili bëhet shkak për respektimin e të drejtave ndërkombëtare të respektuara në luftë, mund ta gëzojnë statusin juridik të robërve të luftës". (Ruso Charl, "Të drejtat e Konfliktëve të Armatosura" (vëllimi i parë, përkthimi në gjuhën persiane, f. 102-103).

Nga ana tjetër disa ekspertë të tjerë të çështjeve juridike argumentojnë se "sipas paragrafit 2 të nenit 43 të protokollit të parë shtesë, vetëm pjesëtarët e forcave të armatosura [...] janë luftëtarë, "me kuptim të asaj se këta persona kanë të drejtë që drejtpërdrejtë të marrin pjesë në luftë". Anëtarësimi i forcave të armatosura është parakusht për ta gëzuar statusin e luftëtarit dhe "forcat e armatosura" në të drejtat ndërkombëtare konsiderohen organ juridik i palës në konfliktin e armatosur. Nëse një person i cili merr pjesë në konfliktin e armatosur, nuk posedon këto dy kushte të të qenurit luftëtar, nuk mund ta gëzojë statusin e luftëtarit dhe në rast se arrestohet nga armiku, nuk mund ta fitojë statusin sekondar të robërve të luftës". (Felek Diter, "Të Drejtat e Njeriut në Konfliktet e Armatosura", përkthimi në gjuhën persiane, f. 109).

Duke marrë parasysh këto raste, kuptohet se standardi më i rëndësishëm për të identifikuar luftëtarin nga jo luftëtari, është kjo që luftëtar

është një individ i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë merr pjesë në luftë dhe nga ana tjetër, duke marrë parasysh nenin 4 të konventës së Gjenevës, vetëm personat mund ta gëzojnë statusin e robërve të luftës të cilët para se të



kapën robër, të jenë konsideruar luftëtarë. Prandaj mund të thuhet se parimisht jo luftëtarët nëse kapën rob nga pala tjetër e konfliktit të armatosur, çfarëdo lloj statusi që ta gëzojnë, ata nuk do ta gëzojnë statusin e robërve të luftës. Natyrisht se kjo fjalë e fundit nuk do të thotë se personi i arrestuar ose i kapur nga armiku, nuk gëzon kurrfarë të drejtash! Por qëllimi është vetëm ky që personi në fjalë nuk do të gëzojë të drejtat përkatëse me robërit e luftës. Kjo është për arsye se nenet e përbashkëta të katër konventave të Gjenevës theksojnë respektimin e sjelljeve më themelore njerëzore ndaj të gjithë personave të përfshirë në konfliktin e armatosur (duke marrë parasysh pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në luftë).

A mund të quhen pjesëtarët e Muxhahedine Khalk luftëtarë?

Duke marrë parasysh rezultatin e arritur deri më tani, mund të thuhet se parimisht mercenarët inkuadrohen me pagesë në kohën kur për disa arsye, njëra palë e përfshirë në konflikt dëshiron në mënyrën sa më të shpejtë të mundur të ngadhënjë mbi palën e kundër për të marrë më shpejtë privilegje. Prandaj, edhe në mënyrën më të pamundur dhe në formën më të ngushtë (vetëm për ta çuar përpara diskutimin), nëse forcat e organizatës Muxhahedine Khalk nuk

konsiderohen mercenarë duke marrë parasysh faktin se ato gjatë agresionit ushtarak të Irakut kundër Iranit, kanë marrë pjesë në luftë vetëm në mënyrë periodike dhe në disa kohë të caktuara kur sipas arsyeve të ndryshme, çështjet e luftës ishin në dëm të forcave irakiane dhe në realitet kanë luftuar në favor të forcave irakiane dhe në dëm të forcave iraniane, mirëpo duke marrë parasysh faktin se forcat e Muxhahedine Khalk duke vepruar në favor të forcave irakiane, kanë marrë përfitime materiale të mëdha (para dhe pas veprimeve), për këtë arsye pjesëtarët e këtij grupi në asnjë mënyrë nuk mund të quhen luftëtarë.

Gjatë një konflikti të armatosur, secila prej palëve bënë përpjekje që me mënyra të ndryshme, të pengojë veprimet e të gjithë pjesëtarëve të palës së kundërt (duke përfshirë luftëtarët dhe jo luftëtarët dhe personat e përfshirë drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në luftë). Protokollin e parë i shtuar në këtë rast gjatë nenit 37 ka nxjerrë dritë urdhëresa:

"1) Vrasja, plagosja ose kapja rob e një prej forcave të armikut duke përdorur intriga, është e ndaluar. Veprimet që bëhen shkak për ta fituar besimin e një prej pjesëtarëve të forcave armike duke e bindur atë se në bazë të ligjeve dhe rregullave të të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në konfliktet e armatosura, ai ka të drejtë të gëzojë mbrojtje ose shteti në fjalë obligohet që t'i japë atij mbrojtjen e vet dhe qëllimi të jetë të tradhtohet kjo ndjenjë e besimit, quhen intriga. Veprimet e shpjeguara më poshtë konsiderohen intrigë: a) paraqitja e një palë se dëshiron të bisedojë nën flamurin e armëpushimit ose dorëzimit; b) shtirja e personit si i pamundur për shkak të plagosjes ose sëmundjes; c) paraqitja e personit si civil dhe shtirja se gëzon statusin e jo luftëtarit; d) paraqitja e personit se posedon statusin që gëzon mbështetje duke përdorur simbole dhe shenja ose uniforma të unifikuara në at formë që i përkasin Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose që i përkasin shteteve të paanshme ose shteteve të tjera që nuk janë palë të përfshira në konfliktin e armatosur.

2) Mashtrimet luftarake janë të ndaluara. Mashtrime konsiderohen veprimet të cilat bëhen

për të mashtruar armikun ose për ta shtyrë atë që të bëjë veprime të pakujdesshme të cilat sidoqoftë në këtë mënyrë nuk konsiderohen në kundërshtim me ligjet e së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në konfliktet e armatosura dhe nuk konsiderohen intrigë. Kjo është për arsye se këto mashtrime nuk krijojnë ndjenjën mirëbesimit tek armiku në shkëmbim të mbrojtjes në bazë të ligjeve të lartpërmendura. Shembuj të këtyre mashtrime janë: fshehja, shfrytëzimi i kurtheve, kryerja e operacioneve improvizuese dhe dhënia e informacioneve të gabuara".

Një prej mënyrave për kryerjen e këtyre mashtrimeve luftarake është kryerja e operacioneve inteligjente dhe të sigurisë të cilat kryhen nëpërmjet agjentëve të spiunazhit.

Definicioni i agjentit (spiunit)

Neni 46 i protokollit të parë në lidhje me agjentët e spiunazhit përcakton:

"1) pavarësisht rregulloreve të tjera të konventave dhe të këtij protokollit, çdo pjesëtar i forcave të armatosura të një pale në konfliktin e armatosur i cili kapët nga forcat e palës së kundërt gjatë kryerjes së spiunazhit, nuk ka të drejtë ta gëzojë statusin e robërve të luftës dhe ai mund të trajtohet si një spiun.

2) Secili pjesëtarë i forcave të armatosura të një pale në konfliktin e armatosur i cili nga ajo palë dërgohet në territorin e kontrolluar nga pala tjetër për të mbledhur informacione ose të bëjë përpjekje për këtë qëllim, nëse gjatë kryerjes së misionit mbanë uniformën e forcave të tij të armatosura, nuk konsiderohet spiun.



3) Çdo pjesëtar i forcave të armatosura të një palë të përfshirë në konfliktin e armatosur është me qëndrim në një territor i cili ndodhet i pushtuar nga pala e kundërt dhe nga ajo palë të cilës i përket, merr mision për të mbledhur informacione që kanë vlerë ushtarake brenda atij territori ose bënë përpjekje për këtë qëllim, veprimi i tij nuk do të konsiderohet spiunazh, përveç në rast se këtë veprim ai e kryen me anë të mashtrimeve ose me vetëdije dhe në mënyrë sekrete. Përveç kësaj, personi me qëndrim në territorin e lartpërmendur nuk do të privohet nga e drejta e tij për ta gëzuar statusin e robërve të luftës dhe ai nuk mund të trajtohet si spiun, me përjashtim në rastet kur ai të kapet duke bërë spiunazh.

4) Çdo pjesëtar i forcave të armatosura të një palë të përfshirë në konfliktin e armatosur i cili nuk është me qëndrim në territorin e pushtuar



nga pala e kundërt dhe kryen veprimtari spiunazhi në atë territor, nuk do të privohet nga e drejta që ta gëzojë statusin e robërve të luftës dhe nuk mund të trajtohet si një spiun, përveç nëse kapja e tij

të ketë ndodhur para bashkëngjites përsëri me forcat e tij të armatosura".

Neni 29 i rregullores për mbikëqyrjen e të drejtave dhe normave të luftës tokësore (Hagë 18 tetor 1907), në lidhje me spiunazhin e jep këtë përkufizim i cili duket më i qartë se sa përkufizimi i mëparshëm:

"Neni 29- një person konsiderohet spiun atëherë kur në mënyrë të fshehtë ose me pamje

mashtreuse, mbledh informacione në lidhje me zonën e operacioneve të forcës së armikut dhe i jep ato informacione palës së kundërt. Si rezultat, ushtarët të cilët për të mbledhur informacione, pa ndryshimin e pamjes së tyre, hyjnë në zonën e operacioneve të ushtrisë së armikut, nuk konsiderohen spiunë. Në këtë mënyrë, edhe personat në vijim nuk konsiderohen spiun: ushtarët dhe civilët të cilët kryejnë misionin e vetë në mënyrë të hapur dhe atyre u është dhënë bartja e mesazheve të ushtrisë së vetë ose të ushtrisë së armikut. Gjithashtu kësaj liste duhet shtuar edhe personat të cilët duke shfrytëzuar balonat transferohen nga një vend në vendin tjetër për të dërguar mesazhe dhe për të ruajtur komunikimin mes sektorëve të ndryshëm të një ushtrie ose të një territori".

A konsiderohet spiun Muxhahedine Khalk në bazë të ligjeve të së drejtës ndërkombëtare?

Çështja se për çfarë arsye forcat e Organizatës Muxhahedine Khalk konsiderohen spiun, është një temë e një artikulli tjetër, mirëpo shkurtimisht duke marrë parasysh faktin se ky grup nuk ishte pjesëtar i forcave të asnjërës palë të përfshirë në konfliktin e armatosur Irak-Iran, në bazë të konventës së Gjenevës mund të mos konsiderohet mercenar. Mirëpo duke marrë parasysh nenin 29 të konventës së Hagës dhe në bazë të asaj që spiunazhi është një veprim kundër interesave të një vendi dhe në favor të interesave të një vendi tjetër, parimisht ky veprim mund të konsiderohet krim ndaj një populli dhe ndaj paqes së përgjithshme të një vendi, prandaj sipas

kodit penal të çdo vendi mund të hyjë në kategorinë e krimeve kundër sigurisë dhe qetësisë publike. Në bazë të kësaj, definicioni i spiunazhit në konventat dhe ligjet e të drejtës ndërkombëtare është kujtuar në mënyrë të paqartë dhe në mënyrë të shkurtë dhe boshti kryesor i këtij definicioni i përket sferës së të drejtave të brendshme. Në këtë mënyrë çështja e vërtetimit se grupi Muxhahedine Khalk është grup spiunazh, duhet të shtrohet në bazë të ligjeve kombëtare. Mirëpo shkurtimisht duke marrë parasysh faktin se elementi më i rëndësishëm i natyrës së identifikimit të spiunazhit si një krim ndërkombëtar, është veprimi për mbledhjen e informacioneve në lidhje me zonën e operacioneve të forcës së armikut në mënyrë të fshehtë dhe me pamje mashtreuse dhe në bazë të kësaj, grupi Muxhahedine Khalk mund të konsiderohet grup spiunazh.

Rezultati përfundimtar

Duke marrë parasysh këto raste, mund të thuhet se e drejta e një luftëtari për të gëzuar statusin e robërve të luftës, anulohet në kohën kur ai vetën nuk e ka dalluar nga personat civilë ose kur kapet nga pala tjetër si spiun ose mercenar. Siç duket arsye për të cilën dy kategoritë e fundit nuk përfshihen në statusin e robërve të luftës, është kjo që konventat e Gjenevës dhe protokollet shtesë, këto dy kategori i konsiderojnë persona që prishin rendin e krijuar nga këto konventa dhe faktorë që nuk respektojnë disiplinën e brendshme të forcave të armatosura për ndjekjen e të drejtave ndërkombëtare humanitare (duke

përfshirë ato normative dhe konvencionale). Me fjalë të tjera, mund të thuhet se çdo njësi e përfshirë në konfliktin e armatosur dhe përgjegjësia e veprimeve të saj të jetë pranuar nga autoritetet e larta, konsiderohet luftëtar dhe si rezultat ajo mund ta gëzojë statusin e robërve të



luftës.

Në bazë të rasteve të lartpërmendura, mund të thuhet se civilët janë individë të cilët nuk janë pjesëtarë të forcave të armatosura dhe nuk marrin pjesë në konfliktin e armatosur.

Mirëpo gjatë vrullit të një lufte, a mund të përcaktohet ose të dallohet me lehtësi dhe shpejtësi një ushtarak nga një civil (edhe duke supozuar ekzistimin e qëllimit të mirë)? Përgjigja është "JO". Siç duket për këtë arsye, protokollin e parë i shtuar në paragrafin 1 të nenit 50 kujton: "Në rast të dyshimit se një person a është civil ose ushtarak, ai person konsiderohet civil".

Duhet të merret parasysh se futja e këtij kushti në definicionin përkatës, nuk bëhet shkak që një grup i caktuar i cili në një konflikt të armatosur ka bërë përpjekje që nëpërmjet mercenarizmit dhe intrigave, të shtojë edhe më shumë armiqësinë dhe zjarrin e luftës mes të dy palëve për të zgjeruar interesat e tij personale dhe për realizimin e ambicieve të veta, të mos konsiderohet prishës i paqes dhe i sigurisë kombëtare ose ndërkombëtare. Parimisht mercenarët, janë individë të cilët prishin rendin e krijuar nga konventat përkatëse me konfliktet e armatosura dhe që nuk respektojnë disiplinën e brendshme të forcave të armatosura për të ndjekur të drejtat ndërkombëtare humanitare (duke përfshirë ato normative dhe konvencionale). Për këtë arsye, disa ekspertë të çështjeve juridike në interpretimin e këtij ligji, besojnë se arsyeja e futjes së këtij kushti në definicionin e personave civilë është kjo që "pavarësisht ekzistencës së dyshimit në identitetin e individit, nuk duhet të bëhemi shkak për ta sulmuar atë". (HENCKAERTS, Jean – Marie & DOSWALD – BECK, Louise, CUSTOMARY INTERNATIONAL HUMANITARIAN LAW (vol. 1: rules), Cambridge University Press 2005, p. 24).

Mirëpo nga ana tjetër, personi i cili prish rendin, ligjin ose normën, nuk mund të trajtohet në përputhje me atë rend, ligj ose normë! Kjo është për arsye se parimisht këto rregullore janë vendosur për krijimin e rendit, prandaj konfirmimi i mundësisë për krijimin e trazirave dhe tregimi i alternativave të mundshme për të

shkelur rregulloren në vet atë rregullore (edhe në formë indirekte), bëhet shkak për krijimin e trazirave, kaosit dhe destabilitetit. Në bazë të kësaj pikëpamje, disa ekspertë të çështjeve juridike kanë analizuar se: "mercenari nuk ka të drejtë që duke u bazuar në statusin e tij [si një rob lufte], të vendoset në një pozitë që ta mbrojë veten". (HENCKAERTS & DOSWALD – BECK, p. 394).

Gjatë procesit të gjyqimit në Nuremberg, gjithashtu u paraqit çështja se ligjet e të drejtës ndërkombëtare humanitare nuk i përfshinë mercenarët dhe në fund u arrit ky rezultat se pasi ky lloj i individëve "shton rreziqet si pasojë e luftimeve për shkak të mënyrës së luftës që zhvillon", nuk konsiderohet luftëtarë. Pikërisht për këtë arsye kryesore dhe të rëndësishme, konventat e Gjenevës dhe protokollet e shtuar të tyre, në lidhje me mënyrën e trajtimit të mercenarëve, nuk kanë sugjeruar në mënyrë të qartë rregullore dhe urdhëresa dhe vetëm duke u bazuar në nenin 75 të protokollit të shtuar, mund të thuhet se mercenarët gëzojnë mbështetjen ose mbrojtjen më të vogël të paraparë (parimi i sjelljes njerëzore) në këtë nen.

Gjithashtu duke u mbështetur në paragrafin 4 të nenit të lartpërmendur, këta persona në bazë të ligjit të brendshëm të vendit i cili ka në dispozicion ata, duhet të gjykohen dhe të dënohen. (Për shembull shikoni vendimin e gjykatës revolucionare popullore të Angolas të lëshuar në vitin 1976, gjithashtu marrëveshjen për armëpushim të nënshkruar mes Francës dhe Gjermanisë më 22 qershor të vitit 1949, në të cilën Franca zotohet t'i ndalojë të gathë francezët nga lufta me Gjermaninë ose nga bashkimi me njërin prej armiqve të Gjermanisë. Kjo marrëveshje përcakton se personat që shkelin këtë urdhëresë, do të gjykohen si militantë të paligjshëm.) Prandaj, në bazë të kësaj mund të thuhet se aty ku mercenarët parimisht janë një prej faktorëve të shkeljes flagrante të ligjeve të konflikteve të armatosura, ata mund përndiqen me ligj dhe të gjykohen në gjykatat kombëtare ose ndërkombëtare me akuze të krimeve të luftës.

Nga ana tjetër duhet marrë parasysh këtë çështje se qëllimi i rregullit të ndarjes, nuk është vetëm dallimi dhe identifikimi i luftëtarit nga jo luftëtar, por edhe identifikimi i luftëtarit të ligjshëm nga luftëtar i paligjshëm. Kjo çështje mund të konsiderohet në përputhje me shpirtin e konventave të Gjenevës dhe të protokolleve të shtuar duke marrë parasysh faktin se këto dokumente janë bazat më të rëndësishme të rregulluara për identifikimin e statusit të një individi si një luftëtar i ligjshëm dhe që gëzon statusin si një rob lufte. Kjo është në kohën kur dokumentet e lartpërmendura, heshtin në lidhje me statusin e mercenarëve pasi që ata të kapën nga pala tjetër e konfliktit të armatosur. Prandaj mund të thuhet se në rast të kapjes, mercenarët nuk janë në statusin e robit të luftës dhe vet ata janë përgjegjës për të gjitha veprimet që kanë

njerëzimit nga gjykatat e Nurembergut dhe të Tokios e deri tek Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe duke marrë parasysh parimet e kriminalistikës moderne (ndryshimi i përqendrimit nga krimineli në kundërvajtje dhe parandalim të krimit), si dhe duke marrë parasysh synimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara të shkruara në nenin 1 të Kartës së Kombeve të Bashkuara (mbrojtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, parandalimin dhe mënjanimin e kërcënimeve kundër paqes, ndërprerjen e çfarëdo lloji të agresionit ose të veprimeve të tjera që shkelin paqen dhe kryerjen e veprimeve të tjera që nevojiten për forcimin e paqes globale dhe të ngjashme me këto), më mirë është lufta (konflikti i armatosur) të përshkruhet si një lloj kundërvajtje ndërkombëtare (krim ndërkombëtar) dhe personat e përfshirë në luftë



kryer. Për shembull, nëse veprimet dhe operacionet e tyre kanë shkaktuar vrasjen e forcave të armatosura ose të civilëve, ata mund të përndiqen në mënyrë ligjore me akuzë të vrasjes me qëllim dhe të ngjashme me këtë.

Duke marrë parasysh këto raste, mund të arrihet në këtë përfundim se në bazë të protokolleve dhe konventave të Gjenevës dhe në bazë të definicionit të krimeve të luftës, të krimit kundër

të ndahen në dy kategori: viktimat e luftës dhe kriminelët e luftës.

Në bazë të kësaj, mund të thuhet se protokollet, konventat e Gjenevës dhe parimisht të gjitha rregulloret (duke përfshirë ato konvencionale dhe normative) të konfliktit të armatosur duhet të interpretohen në atë mënyrë që së pari të parandalojnë rritjen dhe zgjerimin e krimeve të luftës, së dyti ky interpretim të jetë në

mbështetje dhe mbrojtje të viktimave të luftës. Prandaj, duhet thënë se pozita e mercenarit, varët nga veprimi i tij! Duke marrë parasysh faktin se mercenarizmi ose është shkelës i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare ose krijon rrethanat të cilat bëhen shkak për shkeljen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, atëherë interpretimi i konventave dhe normave ndërkombëtare duhet të bëhet në favor të reduktimit dhe parandalimit të mercenarizmit.

Organizata e ashtuquajtur Muxhahedine Khalk më 20 qershor 1987, në mënyrë zyrtare deklaroi themelimin e degës ushtarake të saj me emrin "Ushtria Çlirimtare Kombëtare" që në fillim komandanti suprem i saj ishte Masud Rajavi dhe më pas Marjam Rajavi. (Revista mujore e Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit, nr. 38, shkurt-mars 1988, artikulli me titull: "Bilanci i regjimit dhe bilanci i rezistencës në vitin 1987-88", f. 25 dhe 26). Kjo ushtri më së paku ka kryer tre operacione ushtarake të drejtpërdrejta dhe të gjera kundër Iranit gjatë periudhës së luftës së Irakut dhe Iranit dhe gjatë periudhës pas saj të cilat janë si në vijim:

- 1- Operacioni "Aftab" (Dielli) më datë 27 mars 1988 në rrethinën e qytetit Shush dhe në rajonin Feke.
- 2- Operacion "Çelçeragh" më datë 18 qershor 1988, për ta pushtuar qytetin Mehran.
- 3- Operacioni "Forughe Xhavidan" më 25 korrik 1988 (një javë pas pranimit të rezolutës 598 të KS

të OKB nga ana e Republikës Islamike të Iranit), sulmi nga qyteti Kasre Shirin me qëllim pushtimin e Teheranit.

Organizata



Muxhahedine Khalk ka kryer edhe shumë operacione të tjera më të vogla (si vendosjen e minave, sulme kundër bazave të rojave kufitare, vendosjen e pritave e të ngjashme) gjatë periudhës së luftës së Irakut kundër Iranit. Shumica e këtyre sulmeve janë kryer në rajonin e Kurdistanit në emra të ndryshëm si "Pishmargat e Muxhahedine Khalk", "Luftëtarët e Muxhahedine Khalk" dhe të ngjashëm. Gati të gjitha operacionet e tilla, janë kryer në një pjesë të fronteve të luftës së Irakut kundër Iranit e cila quhej "fronti jo aktiv i luftës" dhe si rezultat edhe forcat e Irakut edhe forcat e Iranit në këtë pjesë kishin vendosur më pak trupa dhe pajisje luftarake.

Duke marrë parasysh faktin se operacionet ushtarake por edhe ato politike të Organizatës Muxhahedine Khalk dhe të forcave militante të saj, parimisht kanë qenë në favor të njërës palë të përfshirë në konfliktin e armatosur, do të thotë Irakut, si dhe duke marrë parasysh faktin se asnjë prej operacioneve të mëdha ose të vogla të tyre nuk kanë fituar mbështetjen e qytetarëve dhe banorëve të zonave përkatëse dhe në të shumtën e rasteve veprime të tilla janë përballur me reagim rezistues të banoreve duke i trajtuar forcat e Muxhahedine Khalk si forca agresore ndaj territorit të Iranit, gjithashtu duke marrë parasysh faktin se Muxhahedine Khalk ka bashkëpunuar gjerësisht në fushën e inteligjencës, të sigurisë dhe ushtarake me regjimin Ba'th të Irakut, kjo organizatë nuk mund të futet në kategorinë e lëvizjeve çlirimtare. Prandaj mund të thuhet se Organizata

Muxhahedine Khalk dhe strukturat e saj gjatë periudhës së luftës së Irakut kundër Iranit, kanë vepruar si një grup

Sipas konsullatës amerikane në Dubai, pas

një sondazhi të kryer me disa iranianë në vende të ndryshme, kjo konsullatë në majt të vitit 2010, ka publikuar një raport ku shihet se populli iranian urren grupin terrorist Moxhahedine Khalk.

Rezultati i një sondazhi të zhvilluar me njerëz të zakonshëm dhe analistë iranianë brenda dhe jashtë vendit, tregon se grupi Moxhahedine Khalk nuk gëzon aspak popullaritet. Të anketuarit kanë shprehur urrejtje të madhe kundër këtij grupi. Kjo urrejtje shprehet kryesisht për shkak të ndihmës që ky grup terrorist i ka ofruar Sadam Huseinit në luftën tetë vjeçare midis Iranit dhe Irakut. Të gjithë iranianët që kanë pjesë në këtë sondazh, nuk besojnë në idealet e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut të grupit Moxhahedine Khalk. Edhe grupet opozitare dhe të pakicave siç është grupi Beha'i, thonë se qeveria aktuale iraniane është më e preferuar se grupi Moxhahedine Khalk. Shumica e të anketuarve besojnë se mbështetja e Amerikës për grupin Moxhahedine Khalk dëmton interesat e këtij vendi dhe ul popullaritetin e Amerikës në mesin e popullit iranian, sidomos të atyre iranianëve që kundërshtojnë qeverinë aktuale të Iranit. Bile një gjë e tillë bëhet shkak për rritjen e ndjenjave anti-amerikane dhe forcimin e mundshëm të ekstremistëve iranianë.

Opinion i qytetarëve Iranianë në lidhje me Moxhahedine Khalk

Shënim: Raportin të cilin do ta paraqesim në vijim, përbëhet nga intervistat e vëzhguesve iranianë në Departamentin Amerikan të Shtetit dhe misionarët e konsullatave nëpër stacione që në mënyrë të rregullt kanë pasur raporte me iranianët. Këto stacione kanë qenë të

vendosura në Ankara, Baku, Berlin, Dubai dhe Stamboll.

Përmbledhje: Rezultati i një sondazhi të zhvilluar me njerëz të zakonshëm dhe analistë iranianë brenda dhe jashtë vendit, tregon se grupi Moxhahedine Khalk nuk gëzon aspak popullaritet. Të anketuarit kanë shprehur urrejtje të madhe kundër këtij grupi. Kjo urrejtje shprehet kryesisht për shkak të ndihmës që ky grup terrorist i ka ofruar Sadam Huseinit në luftën tetë vjeçare midis Iranit dhe Irakut. Të gjithë iranianët që kanë marrë pjesë në këtë sondazh, nuk besojnë në idealet e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut të grupit Moxhahedine Khalk. Edhe grupet opozitare dhe të pakicave siç është grupi Beha'i, thonë se qeveria aktuale iraniane është më e preferuar se grupi Moxhahedine Khalk. Shumica e të anketuarve besojnë se mbështetja e Amerikës ndaj grupit Moxhahedine Khalk dëmton interesat e këtij vendi dhe ul popullaritetin e Amerikës në mesin e qytetarëve Iranianë, sidomos të atyre iranianëve që kundërshtojnë qeverinë aktuale të Iranit. Bile një gjë e tillë bëhet shkak për rritjen e ndjenjave anti-amerikane dhe forcimin e mundshëm të ekstremistëve iranianë.

MEK-Sfondi: MEK është një grup islamist-marksist i cili u formua në vitin 1960 me qëllim përmbysjen e regjimit Pahlavi. MEK është organizatë që bëhet e njohur në ditët e para të fillimit të Revolucionit Islamik në vitin 1965. Muxhahedin-e-Khalk e ndihmoi Imam Khomeinin në përmbysjen e regjimit të Shahut. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, anëtarët e MEK vranë 6 shtetas amerikanë, përkrahën sulmin kundër ambasadës së SHBA në Teheran dhe kundërshtuan lirim të pengjeve amerikanë. Në vitin 1972, Muxhahedin-e-Khalk shpërtheu bomba me sahat në mbi 10 lagje të Teheranit. Këto shpërthime ndodhën në vende të tilla si Shoqata irano-amerikane si dhe në selitë e Pepsi-Cola dhe General Motors. Nga viti 1972 deri në vitin 1975, Muxhahedin-e-Khalk ka vendosur bomba në vende të tilla si zyra e kompanisë ajrore Panamerikan, Shell dhe ndaj disa institucioneve britanike në Iran. Nga mesi i

viteve 1980, MEK, për shkak të shtypjes nga qeveria e Iranit dhe për arsye të mungesës së përkrahjes popullore, nuk mundi të kryejë sulme efikase terroriste. Në vitin 1987, Muxhahedin-e-Khalk krijoi në lindje të Irakut dhe në rajonet kufitare me Iranian një degë të armatosur të quajtur Ushtria Çlirimtare Kombëtare e Iranit. Ky grup në vitin 2003 ka humbur mbështetjen e qeverisë së Irakut.

Vëzhguesit iranianë në Departamentin Amerikan të Shtetit dhe misionarët konsullor në stacionet kryesore (Ankara, Baku, Berlin, Dubai dhe Stamboll) të cilët mbanin kontakte të rregullta me iranianët, në shkurt të vitit 2011 kërkuan nga iranianët të shprehin opinionet e

shkak të ndihmës që ky grup terrorist i ka ofruar Sadam Huseinit në luftën tetë vjeçare midis Iranit dhe Irakut.

Në vazhdim do të citojmë mendimet e disa iranianëve që jetojnë brenda dhe jashtë Iranit: “Si të moshuarit ashtu edhe të rinjtë iranianë e urrejnë grupin MEK, edhe pse shumë të rinj iranianë nuk kanë shumë informacione në lidhje me këtë grup, ata për aq sa kanë informacione dhe din për këtë grup, e akuzojnë atë për mbështetjen që i ka ofruar qeverisë irakiane gjatë luftës Iran-Irak. Shumica e të rinjve iranianë janë të vetëdijshëm se ky grup nuk gëzon mbështetje brenda popullit iranian, por shtrojnë pyetjen se, pse ky grup gëzon mbështetje nga jashtë vendit sidomos nga disa organizata ndërkombëtare”.

“Populli iranian i urren këtë grup, sepse ai duart i ka të lyera me gjakun e njerëzve të pafajshëm”.

“Unë jam një iranian Beha’i dhe mund t’ju them se më shumë e preferoj qeverinë aktuale të Iranit sesa grupin MEK”.

“Ne jemi të frikësuar, sepse mendojmë se janë në kërkim të pushtetit. Ata janë sikur Fidel Kastro në Kubë. Ata dëshirojnë ta shndërrojnë Iranin në Kore të Veriut apo Kubë. Nuk është e drejtë t’i themi atyre grup terrorist. Ata kërkojnë vetëm pushtet. Ata nuk e kanë mbështetjen e shumicës së popullit. Ajo që e kanë zgjedhur një grua për presidente të Iranit, dëshmon se ata nuk janë demokratikë”.

“Populli, sidomos të rinjtë gjatë periudhës së Revolucionit i kanë dashur ata dhe i kanë mbështetur ata. Ne i donim ata. Ishin njerëz të mirë, por ideologjia e tyre islame-marksiste është e vdekur. Ideologjia e këtij grupi ka shumë distanca nga njerëzit e sotëm”.

“Përpos mbështetjes që ata i kanë ofruar Sadam Husejnit, udhëheqësia e tyre është e pamoralshme. Masud Raxhavi ka shkuar me shumë gra dhe Marjam Raxhavi është e



tyre në lidhje me MEK.

Pas intervistave me qindra iranianë, shumica prej tyre kanë shprehur njëzëshëm urrejtjen kundër MEK. Reagimet e tyre karakterizoheshin ose me fyerje kundër këtij grupi ose me mosmbështetje. Kjo urrejtje shprehet kryesisht për

vetëdijshme për këtë çështje. Ata në kampin e tyre në Irak i ndajnë fëmijët nga prindërit. Një anëtar i lartë i familjes time iu bashkua grupit MEK dhe e tërë familja e tij kanë shkëputur lidhjet me të”.

“Askush nuk i pëlqen ata”.

“Ata nuk gëzojnë mbështetje në Iran”.

“Ky grup nuk gëzon mbështetjen e popullit. Populli i urren ata dhe ata janë terroristë. Ata kanë vrarë shumë njerëz”.

“Ka qenë njëherë një kohë kur ata kishin mbështetje, por tani nuk e di se kush janë dhe çfarë bëjnë”.

“MEK është një shaka”.

“MEK nën udhëheqjen e Merjem Raxhavi dhe me presidente Merjem Raxhavi në atmosfera e tanishme politike të vendit nuk kanë asnjë vlerë dhe kuptim. Megjithatë, ata ajanë duku u munduar ta shfaqin veten si grup opozitar iranian në mërgim”.

Këto përshkrime të njerëzve të zakonshëm të MEK kanë ndikuar tek analistët politikë iranianë që të forcojnë opinionet e tyre për këtë grup. Analistët thonë se pa asnjë përjashtim grupi MEK në Iran nuk gëzon popullaritet.

Në vazhdim do të shfaqim disa citate të analistëve të njohur bashkëkohor iranianë të cilët kanë lindur në Iran.

MEK në fillim të Revolucionit në vitin 1979 ka gëzuar mbështetje të madhe në Iran, sidomos nga të rinjtë. Ky grup bile edhe pas fillimit të terrorizimit dhe vrasjes së zyrtarëve iranianë në qershor të vitit 1981 dhe përgjigjes së Iranit duke ekzekutuar një numër të madh të pjesëtarëve të MEK, ka gëzuar mbështetje, por udhëheqësia e Grupit MEK më pas ka ikur nga Irani, ku fillimisht ka shkuar në Francë e më par në Irak.

Ata në Irak kanë bashkëpunuar me regjimin e Sadamit. Ky veprim ka krijuar urrejtje në mesin e popullit iranian. Ky grup e ka ndihmuar Sadamin në zbulimin e shumë informacioneve dhe një veprim i tillë ka irrituar në masë të madhe popullin iranian kundër këtij grupi. MEK nuk kishte ndryshuar vetëm planin e tij kundër Iranit, por e kishte përshkallëzuar atë. Ish anëtarët e MEK të cilët u dëshpëruar nga udhëheqësia e këtij grupi, kanë bërë rrëfime të tmerrshme për këtë grup. Ata kishin shprehur dëshirën për të braktisur kampin pas torturave që ju bëheshin dhe më pas i dorëzoheshin aparatit të inteligjencës së Sadamit si spiunë të Iranit. Po ashtu është zbuluar se pjesëtarët e MEK pas luftës së parë të Gjirit Perik, kanë qenë të parët që kanë shtypur kryengritësit shiitë në jug të Irakut dhe kryengritjen e kurdëve në veri të këtij vendi.

Ata kanë zbuluar shumë informacione rreth programit bërthamor të Iranit dhe kjo gjë ka shkaktuar zemërim tek iranianët, duke e konsideruar këtë veprim si tradhti. Si rezultat, shumë nga anëtarët e këtij grupi janë ekzekutuar. Duke pasur parasysh se 70 % e popullit iranian janë nën oshën 35 vjeç, ata nuk e njohin grupin MEK. Iranianët të cilët e njohin këtë grup, e konsiderojnë atë si një kult fetaropolitik. Struktura politike e këtij grupi që pretendon të veprojë në Iran është e krijuar në këtë mënyrë, sipas një lideri të madh (Masud Raxhavi) dhe një presidente (Merjem Raxhavi) dhe anëtarë udhëheqës që kërkojnë pajtueshmëri të plotë. Pasi të dalim nga një grop, të bimë në gropën tjetër?”

“Truket e MEK për t’i bindur njerëzit në Iran, bëhet në atë mënyrë që duke pretenduar për shkeljen e të drejtave të njeriut në Iran, ata mundohen të shpifin lloj-lloj gjërash për të njoollor Iranin. Grupi MEK ka mbledhur disa nënshkrime nga disa persona për të shtyrë përpara qëllimet e kësaj organizate. Ky grup posedon pseudonime të shumta. Lëvizja e fundit e protestave në Iran që ka ndodhur pas zgjedhjeve të vitit 2009, ka pasqyruar në mënyrë të qartë faktin se ky grup nuk kishte

mbështetje në Iran e as të mërgimtarëve që jetojnë jashtë Iranit”.

“Në përgjithësi, në kohën kur unë jetoja në Iran u njoha me dy realitetet në lidhje me grupin MEK. Gjeneratat e vjetra e urrejnë këtë organizatë për shkak të dhunës të përdorur në fillim të revolucionit dhe aleancës me Sadam Huseinin gjatë luftës Iran-Irak. Kjo urrejtje nuk kishte të bënte me faktin se qeveria iraniane e bënte përgjegjës këtë grup për shpërthimet e ndodhura në fillim të revolucionit. Përveç kësaj, shumica e njerëzve sekular ose liberalë të cilët unë i njoh, akoma mendojnë se MEK është përgjegjës për ndryshimin e rrugës së Revolucionit drejt Islamit radikal. Pikëpamjet e brezave të rinj në lidhje me MEK përzihen me apatinë dhe mungesën e informacioneve për këtë grup. Unë kam parë se as nxënësit as studentët e universiteteve nuk shfaqin interesim për këtë organizatë. Nëse dëshironi të besoni apo jo, një numër i vogël i nxënësve

gëzon mbështetje politike në Iran. Sulmet terroriste të kryera nga ky grup kanë shtuar urrejtjen tek populli iranian. MEK që nga rënia e pushtetit të Sadam Huseinit në Irak, synon të pozicionohet në SHBA. Amerika edhe pse e kishte vënë këtë grup në listën e organizatave terroriste, përpiqet t’a përdorë atë si një levë apo burim informacioni kundër Iranit.

Shumë organizata të njohura ndërkombëtare të drejtave të njeriut siç janë Human Rights Watch apo edhe Amnesty International, e kanë konsideruar grupin MEK si jodemokratik. Kur unë isha duke jetuar dhe punuar në Iran, e shihja se grupi MEK nuk gëzonte aspak përkrahjen e popullit iranian. Qindra persona me të cilët unë kam biseduar, asnjëri nga ta nuk ka thënë ndonjë gjë pozitive për grupin MEK. Pas fillimit të trazirave pas zgjedhjeve të vitit 2009 në Iran, MEK menjëherë u aktivizua për të siguruar bashkëpunim me opozitën kundër qeverisë së RII, por MEK me publikimin e lajmit



apo i studentëve më shumë kanë interesim për marksizmin sesa për grupin MEK”.

“Disa grupe apo individ jashtë vendit kanë kërkuar të jenë qendër e opozitës. Një nga këto grupe është organizata MEK. Kjo organizatë nuk

për marrëdhëniet me opozitën, i dha qeverisë iraniane një mundësi pozitive për të vepruar kundër protestuesve. Shtimi i mbështetjes së administratës amerikane për MEK u bë shkak për forcimin e ish presidentit Ahmedinezhad dhe fanatikëve tjerë dhe mbështetja e

brendshme për këta të fundit u rrit edhe më shumë. Si rezultat, Amerika dështoi në realizimin e qëllimeve të saj, sepse veprimet e saj u kthyen bumerang kundër interesave të saj. Nëse Amerika dëshiron të forcojë Ahmedinezhadin dhe ekstremistët tjerë në Iran për një afat më të gjatë, atëherë le t'a mbështesë grupin MEK. Kjo redukton mundësinë e përmirësimit të marrëdhënieve me qeverinë iraniane dhe progresi demokratik në vend kufizohet. Edhe vetë amerikanët e kanë pranuar se rritja e përkrahjes për grupin MEK shton problemet dhe sfidat me të cilat përballet vetë Amerika”.

“MEK është një parti politike e vdekur dhe nuk paraqet më kërcënim për popullin iranian. MEK nuk ka ndonjë mbështetje në mesin e elitës apo njerëzve të zakonshëm në Iran. Një situatë të njëjtë mund të gjeni në të gjitha provincat e Iranit. Edhe pse populli iranian ndjek uebsajtet e opozitës, sajti i MEK nuk ka vizitorë. Ky është një fakt që dëshmon se grupi MEK është njëri ndër grupet më të urryera në Iran.

Nëse populli iranian do të duhej të vendoste midis MEK dhe Gardës Revolucionare të Iranit, natyrisht se do ta zgjidhte opsionin e dytë. MEK në Iran njihet si grup terrorist. Njerëzit kanë frikë nga ideologjia e vjetruar, vicioze dhe autokratike e këtij grupi. Regjimi iranian është në dijeni të emrit famëkeq të grupit MEK dhe e përdor atë për qëllime politike. Mbështetja e MEK për protestuesit iranian gjatë trazirave të 2009, ishte një shpërblim për regjimin, për shkak të shumica e njerëzve që dolën në rrugë ishin të dyshimtë. Ata kishin frikë se nëse dalin në rrugë do të abuzoheshin nga MEK. Qeveria po ashtu ka akuzuar grupin MEK për vrasjen e njerëzve në rrugë.

Amerika me përkrahjen e saj për grupin MEK ka dëmtuar besueshmërinë ndaj Amerikës në mesin e popullit iranian dhe ka rritur ndjenjat anti-amerikane në vend. Njerëzit këto veprime i konsiderojnë kundër popullit jo kundër qeverisë. Ata mendojnë se qëllimi i Amerikës nuk është promovimi i lirisë dhe demokracisë

në Iran. Regjimi i Iranit e përdor edhe këtë situatë dhe i përdor si dëshmi për të vërtetuar pretendimet se Amerika është armiku i popullit iranian”.

“MEK është një kult islamik-socialist i cili ka disa mijëra anëtarë. Në katër vitet që kam jetuar në Iran, nuk kam parë ndonjë person apo grup që ka shfaqur interesim për këtë grup. Në anën tjetër, përkrahja që ky grup i ka ofruar regjimit të Sadamit në luftën Iran-Irak, ka ndikuar në shtimin e urrejtjes për këtë grup. Amerika duhet të distancohet nga ky grup”.

Koment: Rezultati i këtij sondazhi joshkencor me njerëz të thjeshtë në lidhje me grupin MEK, vërteton opinionet e ekspertëve të cilët kanë njohuri për Iranin. Ata besojnë se edhe përkundër përkrahjes që ky grup gëzon në mesin e qeverisë amerikane, nuk e gëzon mbështetjen e popullit iranian dhe qytetarët iranianë çdo ditë e më shumë nuk shfaqin interesim për të pasur informacione në lidhje me këtë grup.

Është e qartë se pretendimet e Amerikës për mungesë të lirisë dhe të drejtave të njeriut në Iran, bëhen me kërkesë të grupit MEK dhe Amerika për të çuar përpara interesat e saj, përdor këtë grup.

Në fakt, çdo lloj i simbolit të përkrahjes së Amerikës për këtë grup, nuk ndihmon qëllimin e lirisë dhe demokracisë në Iran, por tërësisht ndikon në mënyrë të kundërt, sipas pikëpamjes së popullit në këtë vend, një veprim i tillë i Amerikës ndikon në forcimin e Ahmedinezhadit dhe ekstremistëve tjerë.

Shtojcë: Historia e MEK

1965: Ish anëtar të lëvizjes së lirisë së Iranit, kanë krijuar grupin MEK me ideologji islamiste-marksiste.

1970: MEK përmes ideologjisë së tij, zhvilloi luftë të armatosur kundër regjimit të Pahlavit, duke vrarë ushtarë, civilë dhe qytetarë amerikanë në Iran.

Parstoday është një sajt informativ iranian, i cili duke shfrytëzuar përvojën mbi 70 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm të RTV të Iranit (IRIB Worldservice), ka filluar në një formë të re mediatike aktivitetin e tij në Janar 2016, duke transmetuar në mbi 30 gjuhë të botës lajme dhe informacione mbi zhvillimet kryesore në rajon dhe të botë.

Parstoday posedon shërbime mediatike si website, radio, transmetim përmes valëve në frekuenca, në internet dhe në celular si dhe në rrjetet sociale. Parstoday i transmeton informacionet për publikun në gjuhët shqip, arabisht, armene, bengale, kineze, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, husa, hebreje, indiane, indoneziane, italisht, japoneze, kazake, savahili, pashtun, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht dhe numri i redaksive në gjuhë të huaja do të shtohet.

Zhvillimet politike në Lindjen e Mesme dhe roli i rëndësishëm i Iranit si një vend ndikues në rajon dhe si një vend i sigurt dhe në zhvillim, e shton edhe më shumë rëndësinë e Parstoday si një media me ndikim.

Parstoday në gjuhën shqipe ofron për publikun programe dhe emisione me tematika informative, politike, kulturore dhe fetare duke informuar opinionin me të pathënat e mediave botërore.

Programet e Parstoday në gjuhën shqipe ofrohen për miliona shqiptarë në rajonin e Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të botës, të cilët janë të interesuar të njihen realisht me zhvillimet në Iran, në lindjen e Mesme dhe në vendet banuara nga popullsia shqiptare.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me ne.

Parstoday.com/sq



albanian@parstoday.com

Tel: +98-21-22162833

Tel: +98-21-22162716

Celular: +98-903-5065501



facebook.com/ParsTodayAlbanian



instagram.com/parstodayalbanian



@ParsTodaySq